

DEKLARATA E OREKSIT PËR RREZIKUN E KRIMIT FINANCIAR

Versioni i Dokumentit	V.3		
Audienca	Të gjithë		
Periudha Minimale e Përditësimit		Lloji	Politikë
Krijuesi i Dokumentit	Departamenti i Përputhshmërisë dhe PPP	Kategoria	Kategoria Informacion Publik 1:
Data e Aprovimit	05.03.2025	Aprovuar nga	Bordi i Drejtorëve

© Copyright BKT 2025. Të gjitha të drejtat të rezervuara

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, përkthehet, përshtatet, rregullohet, ose të ndryshohet në çdo lloj mënyre, të shpërndahet, komunikohet, huazohet, ruhet në sisteme të dhënash, apo të transmetohet në çdo formë a mënyrë, elektronike, mekanike, të fotokopjohet, regjistrohet apo të shfaqet për publikun, apo të jetë objekt i çdo veprimi a aktiviteti që ligji e mbron në favor të zotëruesit të të drejtës së autorit, pa lejen paraprake me shkrim nga BKT.

DEKLARATA E OREKSIT PËR RREZIKUN E KRIMIT FINANCIAR

PËRMBAJTJA

1.	TERMINIOLOGJIA	4
2.	HYRJE.....	4
3.	QEVERISJA DHE VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM	5
4.	MANAXHIMI DHE KUADRI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM PËR RREZIQEVE PP/FT DHE SANKSIONEVE	5
	4.1. ANALIZA E RREZIKUT.....	5
	4.2. KONTROLLET.....	5
	4.3. PROGARM I NJIHE KLIENTIN TËND (KYC).....	6
	4.4. BANKINGU KORRESPONDENT.....	6
	4.5. APROVIMI I PRODUKTEVE TË REJA.....	6
5.	DEKLARATA E OREKSIT PËR RREZIKUN FINANCIAR	6
	5.1. RREZIKU GJEORAFIK / I VENDIT	7
	5.2. RREZIKU I INDUSTRIE	8
	5.3. RREZIKU I KLIENTIT	8
	5.4. RREZIKU I KANALIT TË SHPËRNDARJES	9
	5.5. RREZIKU I SANKSIONEVE	10
	5.6. MASAT KUNDËR RYSHFETIT DHE KORRUPSIONIT	11
	5.7. MASAT KUNDËR MASHTRIMIT	11
	5.8. TRAJNIMI DHE NDËRGJEGJËSIMI I STAFIT	11
	5.9. RUAJTJA E TË DHËNAVE	12
	5.10.AUDITI	12
6.	RISHIKIMI DHE KOMUNIKIMI	12

PROGRAMI I NDRYSHIMEVE KRYESORE NE MANUALIN E DEKLARATËS SË OREKSIT PËR RREZIKUN FINANCIAR

Data	Seksioni	Përmbajtja e Ndryshimit
25/09/2024	I gjithë dokumenti	Krijimi i dokumentit
28/10/2024	5.1.2. Vendet me Risk të Lartë	Përditësimi i Vendeve me Risk të Lartë
05/03/2025	5.1.2. Vendet me Risk të Lartë	Përditësimi i Vendeve me Risk të Lartë
05/03/2025	5.4. Risku i Kanalit të Shpërndarjes	Shtimi i seksionit të ri

1. TERMINIOLOGJIA

Termi Shkurtimi	/ Përkufizimi
DEKLARATA OREKSIT RREZIKUN FINANCIAR	E PËR Përcakton tipin dhe nivelet e rreziqeve të krimit financiar që banka është e gatshme të marrë përsipër gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj.
BKT	Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.
Krimi Financiar	Krimi financiar është një term i gjerë që përdoret për të përshkruar aktivitetet kriminale që përfshijnë para ose burime të tjera financiare. Ai i referohet çdo aktiviteti të paligjshëm që përfshin përdorimin e sistemeve financiare, institucioneve apo instrumenteve për qëllime të paligjshme, zakonisht me qëllim të gjenerimit të fitimeve për autorët e krimit. Në funksion të këtij dokumenti, ai mbulon pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, evazionin apo shkeljen e sanksioneve, masat kundër ryshfetit dhe korrupsionit, si dhe rrezikun e mashtrimit.
Listat e Personave të Shpallur (Listat SDN)	Lista e Personave të Shpallur (S pecial D esignated N ationals List) është një masë sanksionesh/embargo të vendosura nga qeveritë (vendore ose ndërkombëtare) që ka për objekt terroristët e shpallur, zyrtarët dhe përfituesit e regjimeve të caktuara autoritare dhe kriminelët ndërkombëtarë (p.sh., trafikantët e drogës).
B2B	Nga kompania në kompani (B usiness- to-B usiness)
B2C	Nga kompania tek konsumatori (B usiness- to-C onsumer)
PPP	P arandalimi i P astrimit të P arave
FT	(parandalimi i) F inancimi i T errorizmit
MSB	Biznesi i Shërbimeve Monetare (M oney S ervices B usiness)
MVTS	Shërbime të Transferimit të Parave ose Vlerave (M oney or V alue T ransfer S ervices)
PEP	P erson i E kspozuar P olitikisht
EWRA	Vetëvlerësimi i riskut PPP/FT në kompani (E nterprise- W ide R isk A ssessment)

2. HYRJE

Kjo deklaratë përcakton oreksin e rrezikut që BKT ka ndaj pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, sanksioneve dhe risqe të tjera të krimit financiar për të siguruar përputhshmërinë e bankës me dispozitat e kuadrit rregullator vendor

dhe ndërkombëtar. Dispozitat e përshkruara në këtë dokument zbatohen për transaksionet dhe marrëdhëniet e biznesit me klientët, marrëdhëniet bankare korrespondente dhe palët e tjera me të cilat banka ka vendosur një marrëdhënie biznesi/bashkëpunimi.

3. QEVERISJA DHE VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Bordi i Drejtorëve të BKT është përgjegjës për mbikëqyrjen e riskut të krimit financiar dhe Departamenti i Përputhshmërisë dhe PPP është njësia përgjegjëse për ushtrimin e funksionit të kontrollit të vazhdueshëm dhe raportimit të këtyre rreziqeve (ad-hoc ose në baza periodike).

Banka është e angazhuar maksimalisht për të operuar në përputhje me kuadrin rregullator vendor dhe ndërkombëtar dhe të kontribuojë në luftën globale kundër krimit financiar, duke zbatuar dhe mbajtur masa të forta parandaluese dhe manaxhuese të rreziqeve të PPP/FT. Për këtë qëllim, banka përmirëson dhe përditëson vazhdimisht kuadrin e saj të brendshëm për parandalimin dhe monitorimin e rrezikut të krimit financiar, çka pasqyrohet edhe në Deklaratën e Oreksit për Rrezikun e Krimit Financiar.

BKT gjithashtu mban një kuadër gjithëpërfshirës të menaxhimit të rrezikut të PP/FT dhe Sanksioneve, kuadër i cili thekson rëndësinë e standardeve rregullatore, profesionalizmit, trajnimit të stafit, nivelit të lartë të integritetit dhe përgjegjshmërisë ndaj palëve të interesuara. Oreksi për rrezikun në BKT mbështet si kuadrin e menaxhimit të këtyre rreziqeve ashtu edhe strategjinë e bankës për zbutjen e rreziqeve PP/FT.

4. MANAXHIMI DHE KUADRI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM PËR RREZIQEVE PP/FT DHE SANKSIONEVE

4.1. ANALIZA E RREZIKUT

BKT zbaton teknika dhe procedura të analizës së rrezikut për të vlerësuar ekspozimin ndaj rrezikut që lidhet me produktet dhe shërbimet që ajo ofron, duke i mundësuar bankës të zbatojë masat e nevojshme zbutëse. Faktorët kryesorë që merren parasysh në procesin e vlerësimit të rrezikut janë kategoria e klientit, produktet dhe shërbimet e ofruara, kanalet e shpërndarjes dhe komponentët/rreziku gjeografik. Rezultati i kësaj analize përcakton masat përkatëse që duhet të zbatohen.

4.2. KONTROLLET

Në përputhje me rregulloret vendase dhe ndërkombëtare, BKT zbaton një regjim të kontrollit të përhershëm për të monitoruar rreziqet dhe për të siguruar zbatimin në mënyrë efektive të masave zbutëse për të kufizuar nivelin e rrezikut që mund të ndikojë në veprimtarinë e bankës. Gjithashtu, BKT kryen një vlerësim vjetor gjithëpërfshirës (EWRA) për PPP/FT, rezultatet e të cilit janë subjekt i raportimit tek autoritetet e brendshme dhe të jashtme.

4.3. PROGARM I NJIHE KLIENTIN TËND (KYC)

BKT zbaton një program të fortë monitorimi *Njihe Klientin Tënd*, i cili përfshin kuadrin e brendshëm rregullator, politikën për identifikimin e klientit, zgjidhjet e TI-së për kontrollin e identitetit të klientit dhe të gjitha palëve përkatëse të lidhura, parashikimin për monitorim të vazhdueshëm dhe rishikim periodik të marrëdhënieve të vazhdueshme të biznesit me klientët.

Vëmendje e veçantë i kushtohet marrëdhënieve të biznesit me klientët me rrezik të lartë, duke përfshirë PEP-at apo vendet ose industritë me rrezik të lartë.

4.4. BANKINGU KORRESPONDENT

BKT i kushton vëmendje të veçantë marrëdhënieve bankare korresponde duke aplikuar miratimin, vigjilencën e duhur dhe masat monitoruese is në fazën e pranimit ashtu edhe gjatë marrëdhënies së biznesit.

Këto masa përfshijnë:

- Sigurimi i informacionit dhe dokumentacionit të nevojshëm për të kuptuar plotësisht natyrën e aktiviteteve korresponde, reputacionin, menaxhimin, strukturën e pronësisë (përfshirë Pronarët e Fundit Përfitues) dhe nivelin e përputhshmërisë me rregullimin ligjor dhe mbikëqyrjen e palës tjetër në vendin e saj të regjistrimit.
- Vlerësimi i rrezikut të marrëdhënies bazuar në analizat e kryera.
- Marrja e miratimit nga drejtuesit e lartë për vendosjen e marrëdhënieve të reja korresponde.

BKT zbaton standarde specifike të përputhshmërisë me kërkesat ligjore dhe praktikën më të mira, duke përfshirë ndalimin e mbajtjes së llogarive apo të ndonjë marrëdhënieje tjetër biznesi me bankat guaskë ose me bankat që ofrojnë shërbime për bankat guaskë.

4.5. APROVIMI I PRODUKTEVE TË REJA

BKT i kushton rëndësi të veçantë implementimit të produkteve dhe shërbimeve të reja apo përditësimit të atyre ekzistuese, duke zbatuar një proces të brendshëm të mirëhartuar për rishikimin dhe aprovimin e të gjithë produkteve dhe shërbimeve të reja, apo të ndryshimeve në ato ekzistuese. Një fazë shumë e rëndësishme këtij procesi është vlerësimi i rrezikut të përputhshmërisë dhe PPP/FT/Sanksioneve, duke siguruar që produkti ose shërbimi përfundimtar është në përputhje me të gjitha kërkesat rregullatore dhe kërkesat për zbutjen e rrezikut.

5. DEKLARATA E OREKSIT PËR RREZIKUN FINANCIAR

Për të arritur objektivin e saj në drejtim të zbutjes së rrezikut të krimit financiar, BKT zbaton një kuadër të brendshëm rregullator që mbulon faktorët kryesorë të rrezikut si Rreziku i Vendit, Rreziku i Klientit, Rreziku i Industrisë/Biznesit dhe

Rreziku i Kanalave të Shpërndarjes. Krahës dispozitive procedurale, banka ka një Kuadër shumë të mirë të Auditimit të Brëndshëm; ofron trajnime të vazhdueshme për stafin e saj dhe përdor zgjidhje të mirë-projektuara TI për qëllime të zbutjes së rrezeqeve të krimit financiar.

Me qëllim të qenurit në përputhje me kuadrin rregullator vendas dhe ndërkombëtar, si dhe me detyrimet reciproke që rrjedhin nga marrëdhëniet B2B dhe B2C, duke përfshirë këtu bankat korrespondente dhe ofruesit e shërbimeve si palë të treta, BKT zbaton oreksin e rrezikut për PPP/FT/Sanksionet të detajuar në vijim.

5.1. RREZIKU GJEORAFIK / I VENDIT

Në lidhje me rrezikun e vendit, BKT aplikon qasjen sipas rrezikut si përshkruar në paragrafët në vijim.

5.1.1. Vendet e Ndaluara

BKT nuk kryen transaksione me vendet e mëposhtme:

- Republika Popullore Demokratike e Koresë (Koreja e Veriut)
- Republika Islamike e Iranit (Irani)
- Mianmar

5.1.2. Vendet me Rrezik të Lartë

BKT zbaton masat e **Vigjilencës së Zgjeruar** mbi këto vende:

- Algjeri
- Angola
- Bjellorusi
- Bullgari
- Burkina Faso
- Kamerun
- Bregu i Fildishtë
- Kroacia
- Kuba
- Republika Demokratike e Kongos
- Haiti
- Kenia
- Republika Popullore Demokratike e Laos
- Liban
- Mali
- Monako
- Mozambik
- Namibi
- Nepal
- Nigeri
- Rusi
- Afrika e Jugut
- Sudani i Jugut
- Siri

- Tanzani
- Venezuela
- Vietnam
- Jemen

5.1.3. Vendet me Rrezik të Ulët

Në këtë kategori bëjnë pjesë vendet ndaj të cilave kuadri rregullator vendor dhe ndërkombëtar nuk kërkon aplikimin e masave të veçanta.

5.2. RREZIKU I INDUSTRISE

Sa i takon rrezikut të industrisë, BKT aplikon qasjen sipas rrezikut si përshkruar në paragrafët në vijim.

5.2.1. Industritë e Ndaluara

BKT nuk kryen transaksione me industritë e mëposhtme:

- Armët, mbrojtja, ushtria
- Lojrat e fatit
- Industri të lidhura me marijuanën
- Energjia bërthamore
- Metalet dhe gurët e çmuar
- Bizneset dhe lojërat për të rritur
- Ofruesit e Shërbimeve për Asetet Virtuale
- Biznese të Shërbimeve Monetare (MSB) të pa licensuara, të paregjistruara dhe / ose të parregulluara
- Të pagueshme nëpërmjet llogarive

5.2.2. Industritë me Rrezik të Lartë

BKT zbaton masat e **Vigjilencës së Zgjeruar** ndaj këtyre industrive:

- Ambasadat/Konsullatat
- Industritë Nxjerrëse
- Shoqëri të Tregëtisë së Përgjithshme
- Ofruesit e Shërbimeve të Pagesave
- Agjencitë e Udhëtimeve
- Shitësit e Makinave të Përdorura

5.2.3. Industritë me Rrezik të Ulët

Në këtë kategori bëjnë pjesë industritë ndaj të cilave kuadri rregullator vendor dhe ndërkombëtar nuk kërkon aplikimin e masave të veçanta.

5.3. RREZIKU I KLIENTIT

Në lidhje me rrezikun e vendit, BKT aplikon qasjen sipas rrezikut si përshkruar në paragrafët në vijim.

5.3.1. Kategoria e Klientëve të Ndaluar

BKT nuk mban marrëdhënie biznesi dhe nuk kryen transaksione me këto kategori klientësh:

- Kompanitë që nuk janë të regjistruara në Shqipëri (Kompanitë Jorezidente)
- Klientë të listuar në ndonjë nga listat zyrtare të personave të shpallur SDN)
- Organizata Jofitimprurëse të parregjistruara / rregulluara
- Bankat quackë

5.3.2. Klientët me Rrezik të Lartë

BKT zbaton masat e **Vigjilencës së Zgjeruar** ndaj këtyre kategori klientësh:

- Biznesi i Shërbimeve Monetare / Shërbime të Transferimit të Parave ose Vlerave (MSB dhe MVTs)
- Organizatat Jofitimprurëse
- Klientët Jorezidentë
- PEP-at
- Personat që bashkëpunojnë ngushtë me PEP-at
- Personat e lidhur me PEP
- Organizata bamirësie të rregulluara / rregjistruara
- Trustet
- Aksionet e Prurësit

5.3.3. Klientët me Rrezik të Ulët

Në këtë kategori bëjnë pjesë klientët ndaj të cilëve nuk kërkohet aplikimi i masave të vigjilencës së zgjeruar dhe nuk janë të listuara në ndonjë nga listat e mësipërme (të ndaluar dhe me rrezik të lartë)

5.4. RREZIKU I KANALIT TË SHPËRNDARJES

Banka zbaton një set masash për të zbutur dhe manaxhuar rrezikun që lidhet me kanalin ku kryhet transaksioni. Ndër të tjerë, indikatorë kyç në vlerësimin e rrezikut të kanalit janë vendi ku kanali vepron dhe kategoria e tregëtarit që lidhen me pagesat me karta debiti dhe krediti.

5.4.1. Vendet e Ndaluara për pagesa me karta

BKT nuk lejon kryerjen e transaksioneve me karta debiti dhe krediti në vendet e mëposhtme:

- Afganistan
- Republika Arabe e Jemenit
- Barbados
- Bjellorusi
- Botsvana
- Burkina Faso
- Ishujt Kajman
- Republika Qendrore Afrikane
- Kongo
- Kuba

- Republika Demokratike e Kongos
- Republika Popullore Demokratike e Koresë (Koreja e Veriut)
- Gana
- Gjibraltar
- Indonezi
- Irak
- Republika Islamike e Iranit
- Xhamajka
- Liban
- Republika Arabe e Libisë
- Mauritius
- Mianmar
- Nauru
- Palestine
- Panama
- Federata Ruse
- Senegal
- Somali
- Sudan
- Republika Arabe e Sirisë
- Uganda
- Venezuela
- Zimbabwe

5.4.2. Tregëtarët e Ndalar për pagesa me karta

BKT nuk lejon kryerjen e transaksioneve me karta debiti dhe krediti me kategoritë e mëposhtme të tregëtarëve:

- Tregëtarët e barnave dhe produkteve të tjera farmaceutike
- Shërbime Takimesh
- Agjensitë e Mbledhjes së Borxhit
- Llotaritë e Zotëruara nga Qeveria
- Lojërat e Fatit në Internet
- Garat me Kuaj / Qenë të licensuara nga qeveria
- Dyqanet e dhënies së DVD/Video me qera
- Bastet, duke përfshirë çips për lojëra kazino, për Biletat e Lotarisë, bastet për gara jashtë piste dhe bastet në pistë garash
- Lojëra fati — Gara me kuaj, gara me qen dhe lojëra të tjera fati në internet

5.5. RREZIKU I SANKSIONEVE

BKT zbaton regjimin e sanksioneve të ratifikuara dhe të vendosura nga qeveria shqiptare dhe autoritetet ndërkombëtare si BE, OKB, OFAC, OFSI, SECO, etj. Këto lista janë të integruara në platformat e automatizuara të monitorimit që banka përdor për kontrollin e klientëve dhe transaksioneve. Listat e integruara

përditësohen rregullisht duke i mundësuar bankës të zbatojë çdo ndryshim që ndodh në lista.

5.6. MASAT KUNDËR RYSHFETIT DHE KORRUPSIONIT

BKT nuk toleron ryshfetin dhe asnjë formë korrupsioni. Të gjithë punonjësit e BKT-së dhe palët e treta që veprojnë në emër të BKT-së janë rreptësisht të ndaluar të kenë ndonjë përfshirje në akte ryshfeti dhe korrupsioni. Programi që BKT zbaton kundër ryshfetit dhe korrupsioni përfshin:

- politikat dhe procedurat,
- kanale të dedikuara dhe të sigurta sinjalizuese,
- trajnimi dhe aktivitete të ndërgjegjësimit të stafit,
- aktivitete të monitorimit të vazhdueshëm, raportimit dhe testimit,
- kërkesa të veçanta për marrëdhëniet me zyrtarët publikë ose personat me ndikim politik,
- standardet dhe kërkesat që lidhen me dhuratat, argëtimin dhe mikpritjen, donacionet/sponsorizimet dhe aktivitete të tjera të lidhura.
- standardet për palët e treta dhe vlerësimet e rrezikut.

5.7. MASAT KUNDËR MASHTRIMIT

BKT ka implementuar një Program Kundër Mashtimit me qëllim mbrojtjen e klientëve dhe veprimtarisë së bankës nga çdo rrezik mashtrimi i brendshëm apo i jashtëm. Programi i zbatimit përbëhet nga sa vijon:

- Politika, procedura, standarde.
- Njësia përgjegjëse për menaxhimin e rrezikut të mashtimit.
- Masat zbuluese dhe parandaluese duke përfshirë kontrollet e vazhdueshme.
- Zgjidhje të dedikuara monitorimi.
- Aktivitetet e trajnimit dhe ndërgjegjësimit të stafit.
- Aktivitetet e ndërgjegjësimit të klientëve.
- Kanalet e sinjalizimit dhe ankesave.
- Vlerësimet e rrezikut të produkteve dhe shërbimeve të reja dhe atyre të përditësuar.
- Vlerësimet e rrezikut të marrëdhënieve të biznesit me palët e treta.
- Raportimi i vazhdueshëm dhe periodik i çdo ngjarjeje të rrezikut.

5.8. TRAJNIMI DHE NDËRGJEGJËSIMI I STAFIT

Aktivitetet trajnuese planifikohen dhe ofrohen për të gjithë stafin e Bankës, si në prezencë ashtu edhe në distancë (e-learning dhe udhëzime), duke mbuluar kërkesat ligjore, konceptet kryesore të pastrimit të produkteve të krimit dhe financimit të terrorizmit, tipologjitë sinjalizuese dhe praktikatat më të mira, në lidhje me parandalimin e pastrimit të produkteve të krimit dhe financimit të terrorizmit, raportimin aktivitetesh të dyshimta, dhe çdo çështje tjetër e rëndësishme që zhvillohet në fushën e PP/FT dhe sanksioneve.

Gjithashtu, me qëllim rritjen e ndërgjegjësisë së stafit dhe kulturës së përputhshmërisë, stafi i bankës informohet për zhvillimet dhe rreziqet më të fundit nëpërmjet njoftimeve periodike ose ad-hoc apo revistave dhe buletineve të publikuara të përputhshmërisë.

5.9. RUAJTJA E TË DHËNAVE

Të gjitha detajet dhe informacionet e mbledhura mbahen në formë të shtypur ose elektronike për një periudhë pesëvjeçare pas përfundimit të marrëdhënies së biznesit me klientin ose datës së transaksionit rastësor. Pas skadimit të kësaj periudhe, banka do të fshijë të dhënat personale, përveç rasteve kur, bazuar në kërkesat ligjore kërkohet që të dhënat të ruhen për periudha më të gjata (por në çdo rast, jo më shumë se 40 vjet).

5.10. AUDITI

Përputhshmëria me programin PPP/LFT i nënshtrohet auditimeve periodike nga Auditi i Brendshëm, auditimeve vjetore nga Auditorët e Jashtëm dhe inspektimit/vlerësimit periodik nga Autoritetet Përgjegjëse/Mbikqyrëse.

6. RISHIKIMI DHE KOMUNIKIMI

Kjo deklaratë është subjekt i rishikimit të vazhdueshëm. çdo ndryshim i komunikohet të gjitha palëve të interesuara.